



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 01 Nr. 3683
U. Br.

Nr. i faq. 1 Data: 14/02
Br. str. Datum: 2025

KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal

Datë: 14.02.2025

Mbështetur në nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të Tjera në Komunë, për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit me datë: 14.02.2025 :

T H Ë R R E T

Mbledhjen e -II-të, të Komitetit për Politikë dhe Financa e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **21.02.2025**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit, nga mbledhja e I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Raporti Vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024.
3. Propozim për shfuqizimin e rregullores Sh.01.Nr.22581 e datës 11.07.2023 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste-bizneseve në Komunën e Kamenicës.
4. Propozim-Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për NPL "Dardana" SH.A, Kamenicë.
5. Propozim-Vendim për shfuqizim të Vendimit Sh.Nr.45 të datës:20.05.2002, mbi lejimin e vendosjes së Kiosqeve.
6. Të ndryshme.



Liridon KASTRATI

Kryesuesi i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPublika e Kosoves	
REPublika Kosova	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY	
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. Br.
02	3682
Nr. i faq.	Data:
02	14/02
Br. str.	Datum:
	2025
KAMENICË/A	

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.54 datë: 14.02.2024

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja b) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, Rregullorja Sh.01.Nr.22581 e datës 11.07.2023 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste – bizneseve në Komunën e Kamenicës, Kërkesa - Peticioni Sh.02.Nr.37035 e datës 01.11.2023 e parashtruar nga Bizneset Tregëtare të Komunës së Kamenicës, për Shfuqizimin e Rregullorës Sh.01.Nr.22581 e datës 11.07.2023 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste – bizneseve në Komunën e Kamenicës, nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2024 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

1. Shfuqizohet Rregullorja Sh.01.Nr.22581 e datës 11.07.2023 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të veprimtarive afariste – bizneseve në Komunën e Kamenicës.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, Shfuqizimi i kësaj rregulloreje bëhet për shkak të mangësive të identifikuar gjatë zbatimit të saj dhe ndikimit negativ që ka pasur në zhvillimin ekonomik lokal.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat dhe Emergjencia dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë.
4. Këtij Vendimi i bashkangjitet Kërkesa - Peticioni Sh.02.Nr.37035 e datës 01.11.2023 e parashtruar nga Bizneset Tregëtare të Komunës së Kamenicës.
5. Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Arsyetim

Komuna e Kamenicës, me datë 11.07.2023 ka miratuar në Kuvend Rregulloren Sh.01.Nr.22581 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së veprimtarive afariste – bizneseve në Komunën e Kamenicës.

Gjatë zbatimit të kësaj rregulloreje, është vërejtur se ndalimi i punës ditën e diel ka pasur ndikime negative në qarkullimin financiar të bizneseve lokale, pasi shumë qytetarë po orientohen drejt komunave fqinje për të kryer blerjet e tyre. Për më tepër, në mungesë të një rregulloreje të ngjashme në Komunitat fqinje dhe një vendimi të nivelit qendror për kufizimin e orarit të punës, bizneset në Kamenicë gjenden në një pozitë të pafavorshme konkurruese.

Gjithashtu, kufizimi i punës ditën e diel ka ndikuar në të ardhurat e bizneseve dhe në stabilitetin e punësimit, veçanërisht për familjet që mbështeten në këto aktivitete ekonomike gjë që e dëshmon edhe Kërkesa - Peticioni Sh.02.Nr.37035 e datës 01.11.2023. Ndërsa Ligji për Punën garanton të drejtën e punëtorëve për një ditë pushimi gjatë javës, duke i lejuar ata të punojnë të dielave me një ditë alternative pushimi.

Në bazë të këtyre argumenteve dhe për të krijuar kushte më të favorshme për zhvillimin e sektorit privat, shfuqizimi i kësaj rregulloreje është i domosdoshëm për të siguruar një ambient më konkurrues për bizneset dhe për të nxitur rritjen ekonomike në Komunën e Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat dhe Emergjencia, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Diasporë dhe QSHQ- arkiv..





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.53, datë: 14.02.2025

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) dhe f) të Ligjit Nr.03/L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, neni 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithëshme Administrative, Vendimit Komunal Sh.02.Nr.32660 i datës 10.10.2024 për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2025 dhe parashikimin për vitet 2026 - 2027, si dhe Vendimit Nr.07/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kërkesa Sh.02.Nr.3637 e datës 14.02.2025 e parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A z. Gazmend Mavriqi, Neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) dhe shkronja h) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2025 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE - "DARDANA" Sh.A

1. Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumë 71.000 Euro (Shtatëdhjetë e një mijë euro) për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A.
2. Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Kamenicës, kategoria e Subvencioneve, Kodi buxhetor 16029 e Zyrës së Kryetarit, dhe ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A.
3. Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi bartet nga Komuna në xhironlogarinë bankare të Ndërmarrjes Publike Lokale - "Dardana" Sh.A.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.
5. Këtij Vendimi i bashkangjitet Kërkesa Sh.02.Nr.3637 e datës 14.02.2025 e parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A z. Gazmend Mavriqi.
6. Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Arsyetim

Ky vendim është marrë me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare për blerjen e makinerive punuese dhe pajisjeve të nevojshme për punë për Ndërmarrjen Publike Lokale "Dardana" Sh.A.

Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" Sh.A luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët e Komunës së Kamenicës. Për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve, është e nevojshme që ndërmarrja të pajiset me makineri punuese dhe pajisje të domosdoshme për kryerjen e detyrave operationale.

Ndarja e këtyre mjeteve financiare bazohet në kërkesën Sh.02.Nr.3637 e datës 14.02.2025 e parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A z. Gazmend Mavriqi, duke marrë parasysh rëndësinë e përmirësimit të kapaciteteve teknike dhe operationale të saj. Ky investim synon të lehtësojë funksionimin e ndërmarrjes dhe të sigurojë një mbarëvajtje më të mirë të aktiviteteve të saj.

Bazuar në këto arsye, është vlerësuar e domosdoshme ndarja e mjeteve financiare për të mbështetur Ndërmarrjen Publike Lokale "Dardana" Sh.A.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe QSHQ- arkiv..





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PER SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 01 Nr. 3693
U. Br.

Nr. i faq. 2 Data: 14/02
Br. str. Datum:

KAMENICË/AG

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-rë e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më: 22.01.2025

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës dhe filloj ora 10:20. Në mbledhje përveç anëtarëve të pranishëm ishin edhe shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi dhe përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa Liridon Kastrati i cili për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e XII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa,
2. Shqyrtimi i Raportit të KKSBB-së, për vitin 2024,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor-31 Dhjetor 2024,
4. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës, para se me filluar me mbledhje a keni propozime të tjera për plotësim-ndryshim të rendit të ditës?

Magbule Kastrati-propozoj që të jetë pikë e rendit të ditës kompensim e shujtave të shërbyesve civil.

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- znj. Magbule, në seancën e dhjetorit kjo pikë ishte propozuar dhe për shkak të debateve të shumta dhe mungesës së kuorunit mbledhja mbeti në gjysmë. Andaj, kjo pikë të mbetet kur të vazhdojë mbledhja e dhjetorit, pasi që as rendi i ditës nuk ishte miratuar për shkak të mungesës së kuorunit. Nëse nuk ka propozime të tjera e hedhim në votim rendin e ditës?

Kush është për miratimin e rendit ?

Për.....7

Kundër.....0

Abstenim.....0

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e XII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës, jemi tek pika e parë e rendit të ditës a keni vërejtje rreth procesverbalit, nëse jo e hedhim në votim, kush është për miratimin e procesverbalit?

Për.....7

Kundër.....0
Abstenim.....0

2. Shqyrtimi i Raportit të KKSBS-së, për vitin 2024,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- a keni diskutime për pikën e dytë, nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së dytë?

Për.....7

Kundër.....0

Abstenim.....0

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Tetor-31 Dhjetor 2024,

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- a keni diskutime për pikën e tretë nëse nuk keni e hedhim në votim,

Kush është për miratimin e pikës së tretë?

Për.....7

Kundër.....0

Abstenim.....0

4. Të ndryshme

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- a keni diskutime në pikën në të ndryshme?
Jadranka Nikolić-Kërkojë nga drejtorja e Arsimit që të na sjell raport për të gjithë drejtorët e Shkollave Serbe në Komunën e Kamenicës, të na ofrojnë raportin e kompletuar të mësimdhënësve dhe listën e pagave për secilën shkollë serbe në Komunë për vitin 2024, njëherit kërkojë që ky raport të hyjë si shqyrtim në rend dite në seancën e ardhshme, dhe i njëjti të ju dërgohet secilit këshilltar të Kuvendit Komunal.

Magbule Kastrati-Pyetje për Kryetarin: Ku qëndron çështja për sigurimin e Objektivit për HANDIKOS-in ?

Liridon Kastrati-Kryesues i Komunës së Kamenicës- këto pyetje do të dërgohen me shkrim përmes zyrtareve të kuvendit dhe besoj se përgjigjet do t'i merrni. Nëse nuk keni diskutime të tjera e shpalli të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi mbyllet ora: 10:50

Procesmbajtës


Sabile Arifi

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kamenicës


Liridon Kastrati





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAGANA

Sh. 01 Nr. 3693
U. Br.

Nr. i faq. 2 Data 14/02
Br. str. Datum:
KAMENICE/A 225

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



ZAPISNIK

Sa I-ve sednice Komiteta za Politiku i Finansije održano dana: 22.01.2025

Sednica održana u zgradi opštine i počela u 10:20 časova. Na sednici osim članova prisutni bili i Stručna skupštinska služba, prevodilac i predstavnik OEBS-a. Sednicu otvorio i vodio Predsedavajući Komiteta za Politiku i Finansije Liridon Kastrati koji za sednicu predložio ovaj:

Dnevni red

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa XII-te sednice Komiteta za Politiku i Finansije,
2. Razmatranje Izveštaja OSBZ-e za 2024 godinu,
3. Razmatranje Finansijskog Izveštaja Budžeta Opštine Kamenica za period 1 Oktobar-31 Decembar 2024,
4. Razno.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, pre nego počnemo sa ovom sednicom, ima li drugih predloga za izmene i dopune dnevnog reda?

Magbule Kastrati-predlažem tačka dnevnog reda da bude, naknada za topli obrok za civilne službenike.

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – g-đa Magbule, na decembarskoj sednici ova tačka je predložena, zbog mnogobrojnih debata i nedostatka kvoruma sednica je ostala na pola. Stoga, ova tačka ostaje kada se nastavlja sa decembarskom sednicom, jer i dnevni red nije bio usvojen zbog nedostatka kvoruma, Ako nema drugih predloga stavljam na glasanje dnevni red?

Ko je za usvajanje dnevnog reda?

Za.....7

Protiv.....0

Uzdržano.....0

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa XII-te sednice Komiteta za Politiku i Finansije,

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica, nalazimo se kod prve tačke dnevnog reda, imate li primedbe na zapisnik, ako nema stavljam na glasanje, ko je za usvajanje dnevnog reda?

Za.....7
Protiv.....0
Uzdržano.....0

2. Razmatranje Izveštaja OSBZ-e za 2024 godinu,

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ima li diskusije po drugoj tački, ako nema stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje druge tačke dnevnog reda?

Za.....7
Protiv.....0
Uzdržano.....0

3. Razmatranje Finansijskog Izveštaja Budžeta Opštine Kamenica za period 1 Oktobar-31 Decembar 2024,

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ima li diskusije po trećoj tački, ako nema stavljam na glasanje,

Ko je za usvajanje treće tačke?

Za.....7
Protiv.....0
Uzdržano.....0

4. Razno

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ima li diskusije u tački razno?

Jadranka Nikolić–od Odeljenja Obrazovanja tražim da se dostavi kompletan Izveštaj nastavnika i platni spisak za svaku srpsku školu u Opštini Kamenica, za 2024 godinu, ujedno tražim da se ovaj izveštaj stavi u dnevni red na narednoj sednici i isti se podeli svakom odborniku Skupštine Opštine.

Magbule Kastrati-Pitanje za predsednika, gde se stalo za obezbeđivanje Objekta za HANDIKos-a?

Liridon Kastrati-Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica – ova pitanja pismeno će se dostaviti preko skupštinskih odbornika verujem da ćete odgovor dobiti. Ako nema drugih diskusija današnju sednicu proglašavam zatvorenom.

Sednica završena u: 10:50 časova

Prevod: Rexhep Ibrahim

Zapisničarka


Sabile Arifi

Predsedavajući Skupštine Opštine Kamenica


Liridon Kastrati





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLICA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE CY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 3722
Br. 01 Data: 18/02/2025
KAMENICEJA

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja b) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit (Nr.03/L-040) për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016), nenin 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit e Akteve të Komunës, nenit 70 shkronja h) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Vendimin.Nr.45 të dt. 20.05.2002 i Kuvendit Komunal mbi Lejimin e Vendosies së Kiosqeve, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2025, sjell këtë:

PROPOZIM - VENDIM

Për Shfuqizim të Vendimit Nr.45 të datës 20.05.2002 i Kuvendit Komunal mbi Lejimin e Vendosies së Kiosqeve

1. **SHFUQIZOHET** Vendimi Nr.45 të datës 20.05.2002 i Kuvendit Komunal mbi Lejimin e Vendosies së Kiosqeve.
2. **OBLIGOHEN** Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia dhe Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative në pajtim me aktet ligjore/nënligjore në fuqi për zbatimin e këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr.45 të datës 20.05.2002 i Kuvendit Komunal mbi Lejimin e Vendosies së Kiosqeve, si dhe si dhe të gjitha aktet që kanë të bëjnë me vendosjen e objekteve të përkohshme - kioska, baraka dhe garazhda.
4. **Shtojcë:** Raporti Sh.08.Nr.6758 datës 29.02.2024 për verifikimin e kiosqeve dhe garazhave si dhe Lista e Shfrytëzuesëve të hapësirës publike, Vendimi Nr.45 i datës 20.05.2002 i Kuvendit Komunal, Konkluzioni Nr.460 i datës 10.10.2002 nga Kryeshefi Ekzekutiv për Delegim të kompetencave për shqyrtim të kërkesave dhe lëshimin e lejeve përkatëse për të gjitha barakat e tipit montazh.
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Kryetari i Komunës së Kamenicës me Vendimin Sh.02.Nr.3718 i datës 01 02.2024 ka caktuar Komisionin për Verifikimin e Objekteve montazh – kiosqeve dhe garazhave që janë në shfrytëzim të përkohshëm.

I njëjti ka hartuar Raportin Sh.08.Nr.6758 datës 29.02.2024 për verifikimin e kiosqeve dhe garazhave, Raporti i cili përfshinë Listën e shfrytëzuesëve të hapësirës publike të evidentuar dhe të pajisura me leje urbanistike – pa leje urbanistike, për garazha dhe kiosqe.

Raporti përfshinë: Emrin dhe Mbiemrin e shfrytëzuesit, llojin e objektit, lejen urbanistike, shfrytëzuesin aktual si dhe borxhet deri në vitin 2015, si dhe parregullsitë lidhur me shfrytëzuesin aktual dhe mos pajisjen me leje urbanistike.

Andaj bazuar në të sipër cekurat u vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, dhe QSHQ- arkivi.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality




DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

REFERENC-Ë:	SH.Z nr. _____				
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës z.Kadri Rahimaj Kryesuesin e Kuvendit z.Liridon Kastrati				
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Drejtori për Financa dhe Buxhet znj.Ardita Dërmaku				
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raporti vjetor financiar për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024				
Nr. i Zyrës: Br. Kancelarije: Room No:		Lokacioni: Lokacija: Extencion:	Objekti i Komunës		30.01.2025
Për aktivitet/Za aktivnost/For action/					
Për miratim/Za ushvanje/For aprova/					
Për nënshkrim/Za potpis/ For signature/					
Për komente/Za komentare/For comments/					
A mund të diskutojmë/Dali možemo raspravljati/ May we discuss/					
Vëmendja e juaj/ Vaša pažnja/Your attention/					
Sipas diskutimit/Kako je raspravljeno/As discussed/					
Siç është kërkuar/ Kako je zatraženo/As requested/					
Shënim dhe përgjigje/ Beleška i odgovor/ Note and retur/					
Për informimin tuaj/ Za vašu informaciju/ For your information/					X
Afati/ Rok/Deadline/					

I nderuari z. Kryetar/Kryesues

Në bazë të Ligjit Mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 46, 46.2 Jo më vonë se me 31 Mars të cdo viti kalendarik , Kryetari I komunës duhet të përgaditë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal nje raport permbledhes buxhetor i cili permban te dhenat e percaktuara ne nenin 46.1 dhe më pas duhet të publikohet nga Kryetari i Komunës në faqen e internetit të Komunës.

Me respekt



**KOMUNA E KAMENICËS
OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY**

Raporti Vjetor Financiar

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024

KAMENICË ,Janar 2025

www.kamenica-komuna.org

1. Hyrje

Raporti vjetor Përfundimtar buxhetor, për periudhën Janar-Dhjetor 2024, është përgatitur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit, nr. 03/L – 048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgatitur nga Kryetari i Komunës, mbulon tremujorin e katërt të vitit fiskal dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet.

1.1. Performanca e të hyrave

Grumbullimi i të hyrave buxhetore ka vazhduar edhe gjatë këtij viti . Gjatë kësaj periudhe vlera e inkasimeve ka arritur në 95.11% të buxhetit të planifikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

Të hyrat tatimore kanë shënuar një rënie prej 49.54% , që korrespondon me 295,857.08 € më pakë krahasuar me vitin paraprak.. Të hyrat jo tatimore kanë shënuar një zvoglim krahasuar me vitin paraprak për periudhën Janar-Dhjetor prej 22.82% që korrespondon me 128,134.83€.

Nga inkasimi i të hyrave në vitin 2024, në vlerë prej 966,825.90 €, do të ju paraqesim tabelat më poshtë sipas nënkodeve ekonomike .

1.2. Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore

Kanë arritur në 15,693,066.30 € përgjatë vitit 2024, apo 17.65% më shumë krahasuar me shpenzimet e realizuara gjatë së njëjtës periudhë të vitit paraprak.

❖ **Shpenzimet për paga dhe mëditje** gjatë këtij viti, shënuan vlerën 10,717,383.33 €apo 99.55% nga buxheti i tersishum .Fatura e pagave gjatë periudhës raportuese, paraqet një rritje prej 23.58% apo rreth 2,045,306.88)€ më shumë krahasuar me faturën e pagave në periudhën e njëjte të vitit 2023.Rritja ka ndodhe per shkak te aktvendimeve te gjykatave nga kontrata kolektive ne shume prej 2,265,121.29€

❖ **Shpenzimet në mallra dhe shërbime** kanë shënuar një rritje prej 12.88% krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur 2,000,815.58€ apo 88.52% nga buxheti i terësishum.

❖ **Shpenzime në komunal**, kanë shënuar një rritje 17.18% apo në shumë prej apo 228,331.25 € krahasuar me vitin 2023. Gjatë kësaj periudhe vlera e këtyre shpenzimeve ka arritur 95.23% të buxhetit të terësishum për këtë kategori për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, shënuan rritje prej 21.92% apo në shumë prej 136,007.90 € gjatë këtij viti, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 99.35% krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori për këtë periudhë.

❖ **Shpenzimet kapitale** Ato arritën vlerën 1,975,995.99 €, që është 4.38% më pakë krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar .Ekzekutimi 65.84 % krahasuar me vlerën e përgjithshme të buxhetuar për këtë kategori.

Në vazhdim ju paraqesim tabelat e inkasimit të të hyrave vetanake për periudhë tremujore krahasuar me planifikimin sipas Drejtorive dhe tabela e inkasimit të hyrave krahasuar me 3 vite për të njëjtën periudhë.

Në bazë të Ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nëni 46, 46.2 jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik , Kryetari I komunës duhet të përgaditë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal një raport përmbledhës buxhetor i cili përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 46.1 dhe më pas duhet të publikohet nga Kryetari i Komunës në faqen e internetit të Komunës .


Raporti i Buxhetit për periudhen Janar-31 Dhjetor 2024 Buxheti sipas fondeve burimore:

Fondet Burimore	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2024	Krahasimi +/-
Grandi Qeveritar	12,491,393.45	15,280,793.76	122.33
Te hyra vetanake	1,084,565.17	1,016,620.39	93.74
Të hyrat e Bartura 2023-2024	625,687.54	697,875.67	111.54
Donatoret e Brendshëm	94,104.62	45,057.61	47.88
Donatoret e Jashtëm	25,416.89	3,079.44	12.12
TOTALI	14,321,167.67	17,043,426.87	119.01


Në këtë tabelë janë krahasuar periudhat e njëjta të Buxheteve të vitit 2023 dhe 2024

- ❖ Buxheti nga Granti Qeveritar ne periudhen Janar-Dhjetor 2024 është më i lartë se në vitin 2023 për 22.33%
- ❖ Buxheti nga Të hyrat vetanake 2024 ne periudhen Janar-Dhjetor 2024 është më i ulët se në vitin 2023 për 6.26%
- ❖ Buxheti nga Të Hyrat e Bartura 2022/2023 ne periudhen Janar-Dhjetor 2024 është më i lartë se në vitin 2023 për 11.54%
- ❖ Buxheti nga Grandet e Përcaktuara të Donatorëve - Donatoret e Brendshëm ne periudhen Janar-Dhjetor 2024 është më i ulët se në vitin 2023 për 52.12% .
- ❖ Buxheti nga Grandet e Përcaktuara të Donatorëve - Donatoret e Jashtëm ne periudhen Janar-Dhjetor 2024 janë me te uleta me vitin 2022 per 87.88%

❖ PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT FINAL SIPAS FONDEVE BURIMORE




Paraqitja grafike e buxhetit sipas fondeve burimore për vitin 2024



BUXHETI SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE 2024

Fondet Burimore	Janar Dhjetor 2023	Janar Dhjetor 2024	Progresi
Pagat dhe Mëditja	8,683,980.97	10,765,928.07	123.97
Mallra dhe Shërbime	2,022,568.07	2,260,240.36	111.75
Shpenzime komunale	239,095.96	254,423.16	106.41
Subvencione	646,596.99	761,580.60	117.78
Investime Kapitale	2,728,925.68	3,001,254.68	109.98
TOTALI	14,321,167.67	17,043,426.87	119.01

❖ PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT FINAL 2024 SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE KRAHASUAR ME VITIN 2023



Paraqitja grafike e buxhetit sipas Kategorive Ekonomike për vitin 2024




Tabela e lëvizjeve të buxhetit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024

Nr	Kategorit Ekonomike	Buxhetit Filleshtetërisht	Te hyrat e bartura	Donatoret e Brendshem	Donatoret e jashtme	Vendimi i Qeverise nr 01/228 Date 31.10.2024	Vendimi i qeverise 22/233 date 27.11.2024	Vendimi i qeverise 03/23 date 24.12.2024	Vendimi i kuvendit per transfere nr 24/404 date 30.09.2024	
1	Paga dhe Mëditje	8,980,425.59	11,904.52			359,115.33	703,334.00	711,148.63		10,765,928.07
2	Mallra dhe Shërbime	2,274,271.80	66,165.56		1,604.00				(81,801.00)	2,260,240.36
3	Shpenzime Komunale	254,000.00	423.16							254,423.16
4	Subvencione dhe Transfere	647,999.80	21,585.55	10,194.25					81,801.00	761,580.60
5	Shpenzime Kapitale	2,367,119.00	597,796.88	18,219.51	18,119.29					3,001,254.68
		14,523,816.19	697,875.67	28,413.76	19,723.29	359,115.33			0	17,043,426.87

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore :

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për **2,519,610.68€**. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit të qeverisë për **1,773,597.96** vendime të Qeverisë për mbulimin minusave të pagave për shkak të ekzekutimit të kategorisë së pagave për aktvendime të gjykatave €, të hyrave të bartura nga viti paraprak për **697,875,67€**, rritjes së donacioneve të brendshme për **28,413.76€** dhe rritjes së donacioneve të jashtme për **19,723.29€**.

- **Buxheti final për paga dhe mëditje** ishte rritur për **1,785,502.48€**. Rritja ishte si rezultat nga të hyrat e bartura në shumë prej **11,904.52€**, dhe vendimet e qeverisë në shumë prej **1,773,597.96€**/vendimi i datës **31.10.2024** nr **01/228**, vendimi i datës **27.11.2024** nr **22/233** dhe vendimi i datës **24.12.2024** me nr **03/239**.
- **Buxheti final për mallra dhe shërbime** është zvogëluar për **14,031.44€**. Rritja ishte nga të hyrat e bartura 2023 për **66,165.56€** dhe nga donacionet e jashtme prej **1,604.00€** dhe është zvogëluar në shumë prej **(81,801.00)** në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal për transfere nr **2404** datës **30.09.2024**
- **Buxheti final për shpenzime komunale** ishte rritur për **423.16€**. Rritja ishte nga të hyrat e bartura 2023 për **423.16€**
- **Buxheti final për subvencione** ishte rritur për **113,580.80€**. Rritja ishte nga të hyrat e bartura 2023 për **21,585.55€**, nga donatorët e brendshëm shuma prej **10,194.25** dhe sipas vendimit të Kuvendit Komunal për transfere të datës **30.09.2024** me nr të vendimit **24404** në shumë prej **81,801.00€**,
- **Buxheti final për shpenzime kapitale** ishte rritur për **634,135.68€**. Rritja ishte nga të hyrat e bartura 2023 për **597,796.88€**, donacionet e brendshme prej **18,219.51€** dhe donacionet e jashtme **18,119.29€**


Tabela e shpenzimeve për vitin 2023/2024 sipas fondeve burimore

Fondet Burimore	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2024	Krahasimi +/-
Grandi Qeveritar	11,969,774.41	14,426,726.00	120.53
Te hyra vetanake	720,275.60	615,551.46	85.46
Të hyrat e Bartura 2021,2022	550,212.33	640,594.84	116.43
Donatorët e Brendshëm	75,884.86	10,194.00	13.43
Donatorët e Jashtëm	22,337.45		-
TOTALI	13,338,484.65	15,693,066.30	117.65

Në këtë tabelë janë krahasuar periudhat e njëjta të shpenzimeve sipas fondeve burimore për vitin 2024 dhe 2023. Shpenzimet në total sipas fondeve burimore të shpenzuara për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 është rritur për **17.65%**.

- ❖ Shpenzimet nga Granti Qeveritar në periudhën Janar-Dhjetor 2024 është më i lartë se në vitin 2023 për **20.53%**
- ❖ Shpenzimet nga Të hyrat vetanake 2024 në periudhën Janar-Dhjetor 2024 është më i ulët se në vitin 2023 për **14.54%**
- ❖ Shpenzimet nga Të Hyrat e Bartura 2022/2023 në periudhën Janar-Dhjetor 2024 është më i lartë se në vitin 2023 për **16.43%**
- ❖ Shpenzimet nga Grandet e Përcaktuara të Donatorëve - Donatorët e Brendshëm në periudhën Janar-Dhjetor 2024 është më i ulët se në vitin 2023 për **86.57%**.

❖ **PARAQITJA GRAFIKE E SHPENZIMEVE TE BUXHETIT FINAL / REALIZIMIT SIPAS FONDEVE BURIMORE KRAHASUAR ME VITIN 2023**



Paraqitja grafike e buxhetit sipas Fondeve Burimore për vitin 2024





Tabela e shpenzimeve për vitin 2023/2024 sipas kategorive ekonomike

Kategoritë Ekonomike	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2024	Krahasimi +/-
Pagat dhe Mëditja	8,672,076.45	10,717,383.33	123.58
Mallra dhe Shërbime	1,772,484.33	2,000,815.58	112.88
Shpenzime komunale	206,759.74	242,275.36	117.18
Subvencione	620,588.14	756,596.04	121.92
Investime Kapitale	2,066,575.99	1,975,995.99	95.62
TOTALI	13,338,484.65	15,693,066.30	117.65

Në këtë tabelë janë krahasuar periudhat e njëjta të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2023 dhe 2024. Shpenzimet në total sipas kategorive ekonomike të shpenzuara për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 është rritur për 17.65%.

- ❖ Shpenzimet nga Paga dhe Mëditja në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë më të larta se në vitin 2023 për **23.58%**
- ❖ Shpenzimet nga Mallrat dhe Shërbimet në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë më të larta se në vitin 2023 për **12.88%**
- ❖ Shpenzimet nga shpenzimet komunale në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë më ulëta se në vitin 2023 për **17.18%**
- ❖ Shpenzimet nga Subvencionet - në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë më të larta se në vitin 2023 për **21.92%**
- ❖ Shpenzimet nga Investimet kapitale - në periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë më të ulëta se në vitin 2023 për **4.38%**

PARAQITJA GRAFIKE E SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE



Paraqitja Grafike e shpenzimeve sipas Fondeve Burimore per vitin 2024




TABELA E BUXHETIT /REALIZIMIT/ NGA GRANDI QEVERITAR/ 2024

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Te lira	Parashikimi vjetor
SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
11 PAGA DHE SHITESA	10,699,023.56	10,699,023.56	0.00	10,690,794.28	0.00	8,229.28	99.92
13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,909,606.80	1,909,606.80	0.00	1,778,927.98	129,508.44	130,678.82	93.16
14 SHPENZIME KOMUNALE	254,000.00	254,000.00	0.00	242,275.36	7,929.79	11,724.64	95.38
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	644,939.40	644,939.40	0.00	640,210.64	1,287.60	4,728.76	99.27
30 PASURITË JOFINANCIARE	1,773,224.00	1,773,224.00	0.00	1,074,517.74	550,302.78	698,706.26	60.60
Totali I Përgjithshëm	15,280,793.76	15,280,793.76	0.00	14,426,726.00	689,028.61	854,067.76	94.41

PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT-PAGESAVE 2024 NGA GRANDI QEVERTAR /10/




TABELA E BUXHETIT /REALIZIMIT/ NGA TË HYRAT VETANAKE 2024

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim/Obligimi	Bartja ne 2025	Progresi
SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
11 PAGA DHE SHITESA	54,999.99	14,684.53	40,315.46	14,684.53	0.00	0.00	26.70
13 MALLRA DHE SHËRBIME	282,864.00	187,423.99	95,440.01	158,330.14	25,846.53	29,093.85	55.97
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	84,861.40	84,861.40	0.00	84,861.40	0.00	0.00	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	593,895.00	452,113.65	141,781.35	357,675.39	94,333.20	94,438.26	60.23
Totali i Përgjithshëm	1,016,620.39	739,083.57	277,536.82	615,551.46	120,179.73	123,532.11	60.55

TABELA:PARAQITJA GRAFIKE E BUXHETIT FINAL/TË HYRAT VETANAKE 2024DHE SHPENZIMEVE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE




TABELA E BUXHETIT /REALIZIMIT/ NGA TË HYRAT E BARTURA 2023

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Bartja ne 2025	Progresi
SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
11 PAGA DHE SHITESA	11,904.52	11,904.52	0.00	11,904.52	0.00	0.00	100.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	66,165.56	66,165.56	0.00	63,557.46	2,075.45	2,608.10	96.06
14 SHPENZIME KOMUNALE	423.16	423.16	0.00	0.00	0.00	423.16	0.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	21,585.55	21,585.55	0.00	21,330.00	0.00	255.55	98.82
30 PASURITË JOFINANCIARE	597,796.88	597,796.88	0.00	543,802.86	50,927.34	53,994.02	90.97
Totali I Përgjithshëm	697,875.67	697,875.67	0.00	640,594.84	53,002.79	57,280.83	91.79

TABELA E BUXHETIT /REALIZIMIT/ NGA TË HYRAT VETANAKE TË BARTURA 2023




TABELA E BUXHETIT /REALIZIMIT/ NGA DONATORET E BRENDSHËM 31

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Bartja ne 2025	Progresi
SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	10,194.25	10,194.25	0.00	10,194.00	0.00	0.25	100.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	34,863.36	34,863.36	0.00	0.00	16,643.85	34,863.36	0.00
Totali I Përgjithshëm	45,057.61	45,057.61	0.00	10,194.00	16,643.85	34,863.61	22.62

TABELA E BUXHETIT /REALIZIMIT/ NGA DONATORET E JASHTËM/

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Allocated	E paalokuar	Aktuali	Zotim /Obligimet në pritje	Per bartje 2025	Progresi
SUBCL	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
13 MALLRA DHE SHËRBIME	1,604.00	1,604.00	0.00	0.00	0.00	1,604.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	1,475.44	1,475.44	0.00	0.00	0.00	1,475.44	0.00
Totali i Përgjithshëm	3,079.44	3,079.44	0.00	0.00	0.00	3,079.44	0.00

Të Hyrat Vetanake 2024

- Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2024 ishin 733,525.06€ apo rreth 36.99% më pakë se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit,taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.Në total te hyrat per Komunen e Kamenices llogaritur edhe te hyrat indirekte /Gjobat ne Trafik ,Gjobat nga Gjykata dhe Agjencionit Pyjore /733,525.06+233,300.84€)=966,825.90€
- Të hyrat tatimore/Tatimi ne prone/ për vitin 2024 janë te inkasuar ne shume prej 300,135.89€ apo rreth 49.64% me pak se viti 2023.Krahasuar me planifikimin ka nje realizim prej 50.53%.
- Te hyrat jo tatimore per vitin 2024 jane te inkasuar ne shume prej 433,419.17€ apo reth 22.81% me pak se viti 2023.Krahasuar me planifikimin per vitin 2024 ka nje realizim prej 2.52% .

Periudha	Dënimet në trafik	Gjobat nga gjykatat	Agjensioni nga pyjet	Total Denimet + Gjobat	Raporti SIMFK	Realizimi I planit	Plani për vitin 2024	Diferenca
	a	b		c	d	e=c+d	f	g=e-f
Janar	8,790.00	40.00		8,830.00	54,868.10	63,698.10		
Shkurt	6,915.00		570.90	7,485.90	43,202.15	50,688.05		
Mars	7,050.00	910.00		7,960.00	54,068.92	62,028.92		
Prill	16,995.00	1,105.00		18,100.00	106,947.80	125,047.80		
Maj	18,425.00	970.00		19,395.00	58,330.52	77,725.52		
Qershor	12,170.00	1,270.00		13,440.00	61,321.70	74,761.70		
Korrik	35,400.00	1,020.00		36,420.00	56,731.79	93,151.79		
Gusht	22,601.00	430.00	4,019.94	27,050.94	76,380.92	103,431.86		
Shtator	17,645.00	520.00	10,500.00	28,665.00	73,985.73	102,650.73		
Tetor	22,391.00	390.00	1,227.00	24,008.00	51,384.67	75,392.67		
Nëntor	18,415.00	770.00		19,185.00	43,715.34	62,900.34		
Dhjetor	20,871.00	1,890.00		22,761.00	52,587.42	75,348.42		
Total	207,668.00	9,315.00	16,317.84	233,300.84	733,525.06	966,825.90	1,016,620.39	(49,794.49)

Tabela e Realizimit /Inkasimit/ të hyrave komunale per vitin 2024 sipas nenkodeve ekonomike

Kodi	PËRSHKRIMI	Planifikimi 2024	Realizimi 2022	Realizimi 2023	2024	Indexi 2024/2022	Indexi 2024/2023	Progresi ndaj planit
40110	Tatimi ne prone	593,895.00	600,369.74	595,992.97	300,135.89	49.99	50.36	50.54
50001	Taxa e rexhstrimit te automjeteve	62,000.00	69,270.00	73,330.00	77,700.50	112.17	105.96	125.32
50002	Taxa rrugore	1,000.00	229	210	801.00	349.78	381.43	80.10
50029	Taksa per ushtrim te veprimtarise afariste	50,000.00	93,872.29	85,306.25	77,472.10	82.53	90.82	154.94
50009	Taksa per leje ndertimi	41,000.00	47,421.07	81,936.75	21,616.00	45.58	26.38	52.72
50011	Taksa per nderim te pronarit te prone	30,000.00	28,290.00	28,894.00	28,761.00	101.66	99.54	95.87
50012	Taxa nderimi te destinacionit te tokes			9,241.20		#DIV/0!	-	#DIV/0!
50016	Taksa per certifikata te tjera	52,000.00	47,041.00	38,775.50	29,875.00	63.51	77.05	57.45
